

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje nga Kryetari i Trupit gjykues- gjyqtari Arben Hoti, me sekretaren juridike Shqipe Rexhepin, në çështjen penale kundër të pandehurit I.P., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328/2 të KPK-së, i akuzuar nga Prokuroria e Qarkut në Prishtinë – tani Themelore PP.nr 979-2/2010 dt. 22.05.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 03.09.2018, në të cilën ish-in të pranishëm prokurori i shtetit – Shemsije Asllani, i pandehuri I.P. me mbrojtësin av.N.Sh. sipas autorizimit, në vështrim të nenit 363/1 nën par 1.1 të KPPK-së, gjykata në të njëjtën ditë mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **I.P.**, i biri i A., dhe N., e gjinisë M., i lindur me dt. ... në fshatin H., me vendbanim në rr “A.”, Komuna F.K., i martuar, baba i ... fëmijëve, pensionist, ka të përfunduar shkollën e lart për elektro, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Komform nenit 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së,

REFUZOHET AKTAKUZA

Sepse: Nga data e pa vërtetuar e deri me datën 11.10.2010 në shtëpinë e tij në F.K., në rr “A.” p/n, ka poseduar dhe përdorur armën pa leje valide dhe atë: dy pistoleta, një pistoletë të markës TT M – 57, të kalibrit 7.62 mm, me numrin serik 3311 prodhim i ish SFRJ-së, dhe gjashtë plumba të kalibrit 7.62 mm, dhe pistoleta e dytë e markës “Parabel” të prodhimit Korat, të kalibrit 9 mm, me të cilat armë ka shkaktuar rrezikun e përgjithshëm ndaj vjetrave njerëzore dhe gjatë një momenti prej një pistolete ka qëlluar dhe gjatë gjuajtjes vetvetes i shkaktoi lëndime trupor ku më pastaj është transferuar për ofrimin e ndihmës, mjekësore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë.

- me këtë kishte për kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328/2 të KPK-së, sepse prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza për shkak se e njëjta vepër përfshihet në Ligjin për Amnisti.

Ndërsa sa i përket veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291/1 të KPK-së, **HEDHET** poshtë aktakuza dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit për këtë vepër penale, ngase ka arritur afati i parashkrimit absolut i ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria e Qarkut tani Themelore në Prishtinë, ka ngritur aktakuzën PP.nr 979-2/2010, dt. 22.05.2012, kundër të pandehurit I.P., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328/1 të KPK-së dhe në bashkëveprim me veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291/1 të KPK-së.

Duke vepruar në këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.03.09.2018, ku Prokurori i shtetit – Shemsije Asllani para leximit të aktakuzës ka deklaruar se, citat *“bene rikualifikimin e veprës penale dhe paragrafi 1 nuk qëndron ngase kemi edhe veprën penale nga neni 291/1 të KPK e absorbon veprën penale përdorimi i armës, dhe prokuroria qëndron në veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll, shfrytëzim apo posedim te paautorizuar të armëve nga neni 328/2 të KPK-së e qe do të thotë kjo vepër penale është amnistuar andaj i akuzuari ka kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291/1 të KPK-së. Përderisa është amnistuar vepra penale 328/2 të KPK-së prokuroria heq dore, në bazë të ligjit për amnisti”*, andaj gjykata konform nenit 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së mori aktgjykim refuzues.

Prokuroria ka mbetur pran akuzës për veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.1 të KPK-së, ndërsa pasi që kryetari i trupit gjykues është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë të deklarohet lidhur me fajësinë.

Megjithatë në shqyrtim gjyqësor gjykata ka konstatuar se në rastin konkret ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale, në këtë çështje penale, dhe atë për këto arsye;

Sipas dispozitivit të aktakuzës është pretenduar se vepra penale është kryer me datë 11.10.2010, dhe për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.1 të KPK-së, është paraparë dënim burgimi deri në tre vite.

Konform nenit 90 par.5 të KPK-së ndjekja penale nuk mund tëndërmerret nëse kanë kaluar tre vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim. Me veprimet e organeve të ndjekjes është ndaluar afati i parashkrimit dhe nga ajo kohë ka filluar të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.

Megjithatëkonform nenit 91 par.6 ndjekja penale ndalon në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit pra ndalesa absolute e ndjekjes penale, ngase nga data kur pretendohet që është kryer vepra penale 11.10.2010 kanë kaluar mbi 6 (gjashtë) vite, çka do të thotë së në këtë çështje penale ka ndodhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë komfor nen. 454 par.1. të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
P.KR 603/13, dt. 03.09.2018

Sekretare juridike: **Gjyqtari;**
Shqipe Rexhepi Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.